

**VENDIM**  
**Nr. 428, datë 22.6.2022**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 72, DATË 3.2.2021, TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR**  
**FINANCIMIN E NDËRTIMIT TË OBJEKTIT ‘POLI I RI ADMINISTRATIV’,**  
**NJËSIA ADMINISTRATIVE BUBQ, BASHKIA KRUIË, DHE ÇAKTIMIN E**  
**BASHKISË KRUIË SI NJËSI ZBATUESE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” e “iii”, 16, dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe të ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr. 72, datë 3.2.2021, të Këshillit të Ministrave, pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2022, nga Bashkia Krujë për ndërtimin e objektit “Poli i ri administrativ”, Njësia Administrative Bubq, Bashkia Krujë, në masën 190 503 875 (njëqind e nëntëdhjetë milionë e pesëqind e tre mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, i cili do të përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë, dhe i transferohet Bashkisë Krujë, në formën e transfertës së pakushtëzuar.”.

2. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Arben Ahmetaj**